



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive

Nr./Br./No. 1209
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 43
Data/Datum/Data: 16/03/2016
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë /Department of Agriculture Policy and Trade
Trgovine/Department of Agriculture Policy and Trade

DATË/A:	16.03.2016
REFERENC/Ë:	04-73/16
PËR/ZA/TO:	z.Memli Krasniqi, Ministër i MBPZHR-së <i>M.Krasniqi</i>
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Kapllan Halimi, Sekretar i Përgjithshëm i MBPZHR-së <i>per Elan</i>
NGA/OD/FROM	Isuf Cikaqi, Drejtor i Departamentit të Politikave Bujqësore dhe Tregtisë <i>Isuf Cikaqi</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Programi për Pagesat Direkte për vitin 2016

I nderuari z. Ministër,

Në kornizën e zbatimit të politikave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zhvillimin e sektorit rural dhe bujqësor për periudhën 2014-2020, Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregtisë ka përgatitë: Programi për Pagesat Direkte për vitin 2016, në kuadër të të cilit janë përcaktuar dhe adresuar objektivat strategjike të zhvillimit të bujqësisë:

- Rritja e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor;
- Rritja e të hyrave në fermë;
- Rritja e rendimentit;
- Zvogëlimi i importit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Rritja e kapaciteteve përpunuese;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.


M.K.

Në kuadër të Programit për Pagesat Direkte për vitin 2016, iu është dhënë prioritet i veçantë këtyre sektorëve:

Programi për pagesat direkte për vitin 2016

Nr.	Sektorët që do të mbështeten përmes pagesave direkte	Buxheti (€)
1	Pagesa direkte për mbjellje të grurit	6,500,000.00
2	Pagesa direkte për mbjellje të farës së grurit	100,000.00
3	Pagesa direkte për mbjellje të elbit	300,000.00
4	Pagesa direkte për mbjellje të thekrës	100,000.00
5	Pagesa direkte për mbjellje të misrit	2,700,000.00
6	Pagesa direkte për mbjellje të lulediellit	50,000.00
7	Pagesa direkte për vreshtat ekzistuese	2,100,000.00
8	Pagesa direkte për pemishtet ekzistuese	1,000,000.00
9	Pagesa direkte për prodhimtarinë e materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesat vegjetative	100,000.00
10	Pagesa direkte për perime në fushë të hapur	1,500,000.00
11	Pagesa direkte për lopë dhe buallica qumështore	3,600,000.00
12	Pagesa direkte për dele	1,700,000.00
13	Pagesa direkte për dhi	150,000.00
14	Pagesa direkte për bletari	1,500,000.00
15	Pagesa direkte për qumësht sipas kategorive të cilësisë	1,000,000.00
16	Pagesa direkte për pula vojse	210,000.00
17	Pagesa direkte për dosa në riprodhim (derrari)	20,000.00
18	Pagesa direkte për therjet e raportuara të gjedhit	150,000.00
19	Pagesa direkte për bujqësi organike	100,000.00
20	Pagesa direkte për thëllëza	20,000.00
21	Pagesa direkte për akuakulturë	100,000.00
	Buxheti total për vitin 2016	23,000,000.00

Aprovoi



Memli Krasniqi, Ministër i Bujqësisë,
Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

16.03.2016

Data

M.K.

PAGESAT DIREKTE PËR MBJELLJE TË GRURIT

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25. 03. 2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/15. 12. 2006);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - DRITHËRAVE / GRURIT:

Sektori i drithërave është me rëndësi strategjike dhe ekonomike për vendin, duke u bazuar në resurse natyrore dhe numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor. Rëndësia e këtij sektori qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë, blegtorisë dhe agro-përpunimit.

Në Kosovë, për vite me radhë mesatarisht mbillen prej 70 000 deri 90 000 hektarësh me grurë. Rendimentet mesatare të arritura nëpër vite sillen rreth 4 t/h, varësisht nga kushtet agroklimatike dhe prodhuese të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarra agroteknike nga ana e fermerëve.

Në vitet e fundit kemi një zhvillim më intensiv të sektorit dhe është e dukshme rritja e sipërfaqeve të mbjella me grurë, krahasuar me vitet e mëparshme.

Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet të vazhdohet edhe më tutje me mbështetje direkte përmes subvencionimit. Kjo mënyrë e mbështetjes do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes mbështetjes të sektorit me pagesa direkte, synohet të arrihet rritja e prodhimtarisë së grurit. Aktualisht Kosova i plotëson nevojat e veta rreth 70-80% të konsumit me grurë.

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve vjeshtore (grurit) do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së sektorit, duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i disponon vendi.

4. QËLLIMI PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë drithëra/grurë.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët që kultivojnë drithëra/grurë:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kultivojnë grurë dhe i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **2 hektar** me grurë në pronësi;
- Parcela e mbjellë me grurë duhet të jetë së paku **0.20 hektar** e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë së paku **0.50 hektar** e pandarë.

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridikë;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punëshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira, e cila duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve- iradhënsit dhe qiramarrësit;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe/hektar, në vlerë prej **150 €/ha**;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë grurë me sipërfaqe së paku **2 hektar** dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

9. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

MW

10. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 40 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale për Bujqësi.

11. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte (subvencionim) të mbjelljes së grurit është 6,500, 000.00 €.

12. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT:

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

PAGESAT DIREKTE PËR MBJELLJE TË FARËS SË GRURIT

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25. 03. 2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/15. 12. 2006);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - DRITHËRAVE / FARËS SË GRURIT:

Bazuar në të dhënat statistikore, Kosova aktualisht i plotëson nevojat me farë gruri vetëm 10-15%. Për shkak të kostos së lartë të prodhimit, një pjesë e konsideruar e fermerëve e shfrytëzojnë farën vetanake për mbjelljen e grurit (vlerësohet se 20% e fermerëve përdorin farën vetanake për mbjelljen e grurit).

Procesi i prodhimit të farës së grurit është një veprimtari ekonomikisht e kushtueshme, duke i marrë për bazë fazat e prodhimit si: sigurimi i farës cilësore, shumëzimi, parakultura, inspektime fushore, përpunimi, etiketimi, mostrimi i farës si dhe masat shtesë të mbrojtjes. Mbështetja e prodhuesve të farës së grurit do të ndikojë në uljen e kostos së prodhimit të farës.

Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet sigurimi i farës së grurit brenda vendit, me qëllim të rritjes së rendimentit dhe përmirësimit të cilësisë së grurit të prodhuar.

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve vjeshtore (farë gruri) do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë kërkesat e tregut dhe resurset natyrore të cilat i ka vendi.

4. QËLLIMI I PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve prodhues të farës së grurit.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit të grurit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit të farës së grurit dhe grurit merkantil;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Rritja e kapaciteteve përpunuese;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët që kultivojnë farë të grurit:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kultivojnë farë të grurit dhe i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **5 hektar** me grurë për prodhimin e farës;
- Të posedojnë kontratën me kompaninë prodhuese të farës;
- Parcela e mbjellë me grurë për farë ose e marrë me qira për mbjelljen e grurit për farë, duhet të jetë së paku **1 hektar** e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Fara e varietetit të grurit të mbjellë duhet të jetë në Listën e Farërave të Lejuara.

Tab. 1. VARIETETET E GRURIT NË LISTËN E FARËRAVE TË LEJUARA

Nr	Varieteti	Nr	Varieteti
1	ANA	36	AGROUNIJA
2	BRUTUS	37	MAKEDONSKA RANA
3	EVROPA 90	38	EXOTIC

M. G.

4	KRONA	39	Bc RENATA
5	LARA	40	Bc MIHELCA
6	LENTA	41	MIA
7	LUNA	42	MATEA
8	LIBERTA	43	GABI
9	ISENGRAIN	44	EPIDOC
10	ILIRIJA	45	APACHE
11	GOLLUBICA	46	ARLEQUIN
12	JUSTUS	47	ANDINO
13	NEVESINKA	48	BALATON
14	NS 5	49	Bc PRIMA
15	PANONKA	50	SIRTAKI
16	POBEDA	51	EUCLIDE
17	PELISTERKA	52	Kg 56-S
18	RENEANSKA	53	VIZIJA
19	SERPANJKA	54	KRISTINA
20	TINA	55	PLANETA
21	SOISSONS	56	ESPERIA
22	ZHITARKA	57	AMARILO 105
23	SUPER ZHITARKA	58	VITTORIO
24	Mv SUBA	59	STENDAL
25	Mv KOLO	60	ZANZIBAR
26	Mv TOBORZO	61	SIMONIDA
27	Mv MARSALL	62	ZVEZDANA
28	Mv MAKARONI	63	VULKAN
29	Mv BERES	64	ALTEZZA
30	AGROUNIJA PRIMA	65	ADELAIDE
31	MAKEDONSKA RODNA	66	ANTILLE
32	NIKOL	67	LUCIJA
33	PROFETA	68	KATARINA
34	ANDALOU	69	KRALJICA
35	BASTIDE		
Variatete standarde (krahasues): Evropa 90 dhe Pobeda			

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirrollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridikë;
- Dëshminë për sasinë e dorëzuar të grurit në kompaninë prodhuese të farës (duhet të sillet/dorëzohet pas realizimit të procesit të korrje-shirjeve të grurit për prodhimin e farës);
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punëshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira e cila duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve – qiradhënësit dhe qiramarrësit.
- Dëshminë mbi kategorinë e farës së grurit të mbjellë;
- Formularin për sipërfaqet e mbjella me grurë për prodhimin e farës e verifikuar nga MBPZHR-ja);
- Raportin e Inspektoratit fitosanitar - AUV nga inspektimet fushore I dhe II (duhet të sillet/dorëzohet pasi të realizohen inspektimet fushore);

A.K.

- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe-hektar, në vlerë prej **250 €/ha**;
- Pas realizimit të dy inspektimeve fushore nga ana e inspektorëve fitosanitarë-AUV, nëse parcelat i plotësojnë kriteret për prodhim të farës së grurit, atëherë subvencionimi do të bëhet në vlerë prej **250 €/ha**. Ndërsa, nëse parcelat nuk i plotësojnë kriteret për prodhim të farës së grurit dhe refuzohen, atëherë fermerët do të përfitojnë vetëm subvencionin për prodhimtarinë e grurit merkantil në vlerë prej **150 €/ha**.

9. MËNYRA E IMPLEMENTIMIT:

Pas verifikimit të dokumentacionit, realizohen dy inspektime në terren nga ana e inspektorëve fitosanitar-AUV. Inspektimi i parë realizohet pas ngallimit të grurit, ndërsa inspektimi i dytë realizohet pas dy javëve të sipërfaqet e mbjella me grurë për farë (Përgjegjës për inspektim është shërbimi i autorizuar - Inspektorati Fitosanitar AUV), dhe në fund bëhet lëshimi i raportit për sipërfaqet e grurit për farë, të pranuar dhe ato të refuzuara.

10. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas përfundimit të inspektimeve dhe hartimit të listave përfundimtare të përfituesve, dhe kompletimit të dokumentacionit bëhet pagesa e fermerëve përfitues vetëm për sipërfaqet e pranuar për farë të grurit dhe dëshmisë mbi sasinë e dorëzuar të grurit për prodhimin e farës, bazuar në rendimentin mesatar të grurit për vitin aktual. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

11. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë **40 ditë** nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale për Bujqësi.

12. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte (subvencionim) të mbjelljeve të grurit për farë është **100,000.00 €**.

13. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

PAGESAT DIREKTE PËR MBJELLJE TË ELBIT

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25. 03. 2009);

M.K.

- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/15. 12. 2006);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - DRITHËRAVE / ELBIT:

MBPZHR edhe këtë vit do të zgjeroj mbështetjen e fermerëve përmes pagesave direkte me kultura bujqësore të reja për të cilat po finalizohen edhe analizat e prodhimit dhe të tregut. Kjo po bëhet për të rritur prodhimin primar në vend i cili i shërben edhe sektorit të përpunimit.

Elbi është produkt i rëndësishëm në prodhimtarinë e birrës dhe ushqimin e kafshëve.

Në Kosovë, mesatarisht mbillen rreth 3000 ha me elb, rendimenti mesatare ndër vite sillet rreth 3 t/ha, varësisht nga kushtet agroklimatike të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarra agroteknike nga ana e fermerëve.

Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet mbështetje direkte përmes subvencionimit. Kjo mënyrë e mbështetjes do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes mbështetjes së sektorit me pagesa direkte, synohet të rritet prodhimtaria e elbit.

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve me elb do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti.

Sigurimi i ushqimit për kafshë, përdorimi si produkt i rëndësishëm në prodhimtarinë e birrës si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i disponon vendi.

4. QËLLIMI PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë drithëra/elb.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

M. V.

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët që kultivojnë drithëra/elb:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë elb dhe i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **1 hektar** me elb në pronësi;
- Parcela e mbjellë me elb duhet të jetë së paku **0.20 hektar** e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë së paku **0.50 hektar** e pandarë.

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridikë;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punëshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira, e cila duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve – qiradhënësit dhe qiramarrësit.
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë;

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe/hektar, në vlerë prej **100 €/ha**;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë elb me sipërfaqe së paku **1 hektar** dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

9. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

10. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë **40 ditë** nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi.

11. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte (subvencionim) të mbjelljes së elbit është **300,000.00 €**.

PAGESAT DIREKTE PËR MBJELLJE TË THEKRËS

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25. 03. 2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/15. 12. 2006);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT:

Në Kosovë, mesatarisht mbillen mbi 1.000 hektarë me thekër. Rendimenti mesatare ndër vite sillet rreth 2.5 t/ha, varësisht nga kushtet agroklimatike të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarra agroteknike nga ana e fermerëve.

Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet mbështetje direkte përmes pagesave direkte-subvencionimit. Kjo mënyrë e mbështetjes do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes mbështetjes të sektorit me pagesa direkte, synohet të rrite prodhimtaria e thekrës.

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritja e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve me thekër do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti.

Sigurimi i ushqimit për kafshë, përdorimi i madh në industrinë e ushqimit si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i disponon vendi.

4. QËLLIMI PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë drithëra/thekër.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;

M.K.

- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët që kultivojnë drithëra/thekër:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kultivojnë thekër dhe i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **1 hektar** me thekër në pronësi;
- Parcela e mbjellë me thekër duhet të jetë së paku **0.20 hektar** e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë së paku **0.50 ha** e pandarë.

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridikë;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira, e cila duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve - qiradhënësit dhe qiramarrësit;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe/hektar, në vlerë prej **100 €/ha**;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë thekër me sipërfaqe së paku **1 hektar** dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

9. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

10. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë **40 ditë** nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale për Bujqësi.

11. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte (subvencionim) të mbjelljes së thekrës është **100,000.00 €**.

M/V

PAGESAT DIREKTE PËR MBJELLJE TË MISRIT

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25. 03. 2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr. 2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/15. 12. 2006);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT -DRITHËRAVE/MISRIT:

Në Kosovë, për vite me radhë mesatarisht mbillen prej 60 000 deri 65 000 hektarë me misër. Dominon varieteti i misrit kokërr edhe pse në vitet e fundit kemi një ndryshim të strukturës në favor të rritjes së sipërfaqeve të mbjella me misër foragjer. Rendimenti mesatar i misrit nëpër vite sillet nga 4 deri në 4.5t/ha, varësisht nga kushtet agroklimatike dhe prodhuese të vendit tonë, si dhe masat e ndërmarra agroteknike nga ana e fermerëve. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet të vazhdohet edhe më tutje përmes mbështetjes direkte. Kjo masë mbështetëse do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet sigurimi i vetëmjaftueshmërisë me ushqim të koncentruar për kafshë (misër). Kjo mbështetje do të ketë ndikim edhe në uljen e kostos së prodhimeve blegtorale dhe përmirësimin e cilësisë.

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve pranverore (misër) do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i ka vendi.

4. QËLLIMI PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë misër.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;

- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Shfrytëzimi i kapaciteteve përpunuese të ushqimit të kafshëve;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore dhe industrisë përpunuese.

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët që kultivojnë misër:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë misër dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **1 hektar** me misër në pronësi;
- Parcela e mbjellë me misër duhet të jetë së paku **0.20 hektar** e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë së paku **0.50 hektar** e pandarë.

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridikë;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira e cila duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve – qiradhënësit dhe qiramarrësit;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe/hektar, në vlerë prej **150 €/ha**;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë misër me sipërfaqe së paku **1 hektar** dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

9. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

10. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 40 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale për Bujqësi.

11. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte (subvencionim) për mbjellje të misrit është 2,700,000.00 €.

12. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT:

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

PAGESAT DIREKTE PËR MBJELLJE TË LULEDIELLIT

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25. 03. 2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/15. 12. 2006);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - DRITHËRAVE / LULEDIELLIT:

Luledielli është kulturë industriale dhe luan rol të rëndësishëm në industrinë ushqimore dhe atë përpunuese. Përdoret si lëndë e parë në industrinë e vajit, ushqim për kafshët (bimë e gjelbër, e silazhuar) si dhe mbetje të përpunimit industrial (bërsi). Në të kaluarën e afërt dmth. në vitet e '80-'90-ta kjo kulturë është kultivuar në sipërfaqe të mëdha në tokat bujqësore të Kosovës. Sipërfaqet e mbjella me këtë kulturë janë sjellë rreth 10 000 hektarë dhe rendimenti mesatar ka qenë mbi 2 000 kg për hektar.

Në Kosovë, për vite me radhë nuk është kultivuar luledielli, por në vitet e fundit ka filluar të shfaqet interesimi për kultivimin e kësaj kulture vajore. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet të vazhdohet edhe më tutje mbështetja direkte përmes subvencionimit. Kjo mbështetje do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit.

Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet siguri i lëndës së parë për prodhimin e vajit dhe ushqimit të koncentruar për bagëti. Ky veprim do të ketë efekt edhe në uljen e kostos së prodhimeve blegtorale dhe përmirësimin e cilësisë.

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mbjelljeve pranverore (luledielli) do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i ka vendi.

4. QËLLIMI I PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë luledielli.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Shfrytëzimi i kapaciteteve përpunuese të ushqimit të kafshëve;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore dhe industrisë përpunuese.

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët që kultivojnë luledielli:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë luledielli dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **1 hektar** me luledielli në pronësi;
- Parcela e mbjellë me luledielli, duhet të jetë së paku **0.20 hektar** e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë së paku **0.50 hektar** e pandarë.

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridikë;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi, ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira e cila duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve - qiradhënësit dhe qiramarrësit;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

M.K.

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe/hektar, në vlerë prej 150 €/ha.
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë luledielli së paku 1 hektar dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

9. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

10. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 40 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi.

11. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte (subvencionim) të mbjelljes së Lulediellit është 50,000.00 €.

11. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT:

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

PAGESAT DIREKTE PËR PERIME NË FUSHË TË HAPUR

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25. 03. 2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr. 2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/15. 12. 2006);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - PERIMET NË FUSHË TË HAPUR:

Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbjellë me perime, në Kosovë, është rreth 15854 hektarë. Kulturat perimore të cilat kultivohen në fushë të hapur në sipërfaqe më të mëdha janë: speci, domatja, qepa, shalqiri, lakra etj.

Kultivimi i perimeve në fushë të hapur është i përqendruar kryesisht në luginën e Anadrinit, në trekëndëshin që ndodhet në fushën e Dukagjinit në mes të Rahovecit, Gjakovës dhe Prizrenit si dhe në Anamoravë. Rreth 2553 hektarë me speca kultivohen në këtë pjesë. Shalqiri është kultura tjetër me rëndësi, përderisa prodhimi i domateve ka një rritje të sipërfaqeve të kultivuara si në fushë të hapur e po ashtu edhe në ambiente të mbrojtura (serra).

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e sektorit të perimeve në fushë të hapur do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i ka vendi.

4. QËLLIMI I PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë perime në fushë të hapur.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët që kultivojnë perime në fushë të hapur:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë perime në fushë të hapur dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 0.50 ha me perime në fushë të hapur;
- Parcela e mbjellë me perime në fushë të hapur duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e tokës bujqësore e marrë me qira duhet të jetë së paku 0.20 ha.

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit;

M.K.

- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridikë;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi ose
- kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira, e cila duhet të jete e
- lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve – qiradhënësit dhe qiramarrësit;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe – hektarë të mbjellë me perime në fushë të hapur, në vlerë prej 300 €/ha;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë mbjellë/kultivojnë perime në fushë të hapur, me sipërfaqe së paku 0.50 ha dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

9. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

10. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 40 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale për Bujqësi.

11. BUXHETI I PLANIFIKUAR :

Për pagesat direkte (subvencionim) të perimeve në fushë të hapur është 1,500,000.00 €.

12. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT:

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Tab. 2. Kulturat perimore që kultivohen në fushë të hapur dhe që do të mbështeten përmes programit të pagesave direkte

Nr	Emri i kulturës perimore
1	Patatja
2	Domatja
3	Patëllxhani zi
4	Speci
5	Kungulli i Misirit
6	Kungulli
7	Kungulleshe
8	Trangulli
9	Shalqiri
10	Pjepri
11	Lakra
12	Lulelakra

M.K.

13	Spinaqi
14	Marulla (sallata)
15	Pangjari
16	Majdanozi
17	Preshi
18	Qepa
19	Rrepka
20	Hudhra
21	Fasulja monokulturë
22	Bizelja
23	Karrota
24	Asparagu
25	Brokoli

PAGESAT DIREKTE PËR VRESHTAT EKZISTUESE

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25. 03. 2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009)
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/01. 02. 2007);
- Ligji Nr. 04/L-019 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13/01. 09. 2011);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RËNDËSIA E VRESHTARIS:

Spektori i vreshtarisë është me rëndësi strategjike dhe ekonomike për vendin, duke u bazuar në resurse natyrore dhe në numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor. Rëndësia e këtij sektori qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë, si në sektorin e verërave dhe agro-përpunimit.

Sipas të dhënave, nga kadastra e vreshtave, në Kosovë aktualisht janë 3201 hektarë me vreshta dhe më shumë se 5 000 fermerë që merren direkt me kultivimin e vreshtit.

Në vitet e fundit kemi një zhvillim më intensiv të sektorit, janë bërë investime të rëndësishme në sektorin e vreshtave dhe verërave. Për të pasur një zhvillim të

M.V.

qëndrueshëm të sektorit, kërkohet vazhdimi i mbështetjes direkte përmes subvencionimit. Kjo mbështetje do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet mirëmbajtje e vazhdueshme e sipërfaqeve aktuale dhe shtimi i sipërfaqeve të reja me vreshta.

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e mirëmbajtjes së sipërfaqeve më vreshta do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyt e përkrahjes së këtij sektori, ruajtja dhe zgjerimi i sipërfaqeve me vreshta, ndalimin e imigrimit nga zonat rurale në zonat urbane si dhe duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i ka vendi.

4. QËLLIMI PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë vreshta (rrush).

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e vreshtave ekzistuese;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët që kultivojnë vresht (rrush):

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë vresht (rrush) dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 0.10/ha (10 ari) më vresht;
- Sipërfaqja e vreshtit e marrë me qira duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e vreshtit e marrë me qira duhet të jetë së paku 0.10 ha (10 ari) e pandarë.

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;

- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Dëshminë nga kadastra e vreshtarisë mbi sipërfaqen e vreshtit - certifikata origjinale e vreshtit (ky dokument merret në Departamentin e vreshtarisë dhe verërave në Rahovec);
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira e cila duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve - qiradhënësit dhe qiramarrësit;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe/hektarë;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë së paku **0.10 ha** (10 ari) vresht dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi;
- Fermerët që kanë të mbjellë (kultivojnë) vresht prej **0.10 ha deri 100 ha** do të subvencionohen në vlerë prej **1000 €/ha**;
- Fermerët që kanë të mbjellë (kultivojnë) vresht mbi **100 hektarë** do të subvencionohen në vlerë prej **400 €/ha**.

9. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve, bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesa bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

10. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë **40 ditë** nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorit Komunale për Bujqësi.

11. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte (subvencionim) të vreshtave ekzistues është **2,100,000.00 €**.

12. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT:

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

PAGESAT DIREKTE PËR PEMISHTET EKZISTUESE

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25. 03. 2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);

- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012).
- Ligji Nr. 2003/5 i Kosovës për Farërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/15. 12. 2006);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RËNDËSIA E PEMËTARISË:

Sektori i pemëtarisë është me rëndësi strategjike dhe ekonomike për vendin, duke u bazuar në resurse natyrore dhe numrin e madh të fuqisë punëtore të angazhuar në këtë sektor. Rëndësia e këtij sektori qëndron edhe në ndikimin që ka në zhvillimin e sektorëve të tjerë, si në sektorin e prodhimit të materialit fidanor dhe agro-përpunimit.

Sipas të dhënave statistikore, aktualisht në Kosovë janë të mbjella rreth 4400 hektarë me pemë të të gjitha llojeve. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, kërkohet mbështetje përmes pagesave direkte. Kjo mbështetje do të ndikojë drejtpërdrejt në zvogëlimin e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet mirëmbajtje e vazhdueshme e sipërfaqeve aktuale dhe zgjerimi i sipërfaqeve të reja me pemë.

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parashihet rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e sipërfaqeve të tokës bujqësore të mbjella me pemë do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, ruajtja dhe zgjerimi i sipërfaqeve me pemë, ndalimin e migrimit nga zonat rurale në zonat urbane si dhe duke marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i ka vendi.

4. QËLLIMI I PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët kultivojnë pemë.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e pemishteve ekzistuese;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët që kultivojnë pemë:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellura/kultivojnë pemë dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

M.K

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 0.50 ha me pemë drufrutore;
- Të kenë të mbjellë së paku 0.20 ha me pemë të imëta (dredhëz, manaferrë, mjedër, aroni dhe boronicë).
- Parcela e mbjellë me pemë duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë;
- Sipërfaqja e pemshtes e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për 1 vit.
- Sipërfaqja e pemshtes e marrë me qira duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë.
- Pemshtja duhet të jetë e mirëmbajtur (e lëvruar ose e mbjellurë bari në mes të rreshtave, krasitur, mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit) dhe sistemi i mbjelljes të jetë me renditje të qartë dhe të rregullt të rendeve-rreshtave.

Tab. 3. Kulturat pemëtare që do të mbështeten përmes programit të pagesave direkte, numri minimal i bimëve-pemëve në një (1) hektar

Nr.	Emri i kulturës pemëtare	Nr. Minimal i bimëve-pemëve në 1 ha
1	Molla	900
2	Dardha	600
3	Ftoni	750
4	Mushmolla	750
5	Kumbulla	600
6	Kajsia	600
7	Pjeshka	600
8	Qershia	250
9	Vishnja	750
10	Dredhëza	50000
11	Manaferra	1750
12	Mjedra	5250
13	Boronica	1750
14	Arra	250
15	Lajthia	750
16	Aronia	1750

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridikë;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira e cila duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve – qiradhënësit dhe qiramarrësit;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

A.V.

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe/hektar, në vlerë prej 400 €/ha;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë/kultivojnë së paku 0.50 ha me pemë drufrutore dhe fermerët të cilët kanë të mbjellë së paku 0.20 ha me pemë të imëta (dredhëz, manaferrë, mjedër, aroni dhe boronicë) dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

9. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve, bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

10. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 40 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi.

11. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte (subvencionim) për përmishtet ekzistuese është 1,000,000.00 €.

12. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT:

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

PAGESAT DIREKTE PËR PRODHIMIN E MATERIALIT FIDANOR TË PEMËVE DRUFRUTORE DHE HARDHISË SË RRUSHIT TË PRODHUARA MBI NËNSHARTESA VEGJETATIVE

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 2004/13 për Materialin Fidanor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22/01. 03. 2008);
- Ligji Nr 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 01/17 Janar 2013);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RËNDËSIA E MATERIALIT FIDANOR

Zhvillimi i suksesshëm i pemëtarisë intensive varet në radhë të parë nga prodhimtaria cilësore e materialit fidanor, nga varietete më të mira të përfituara përmes seleksionimit klonal, të kultivuara në nënshartesat më të përshtatshme.

Suksesi në krijimin e pemishteve intensive komerciale, në radhë të parë varet nga cilësia i fidanëve, prandaj kësaj prodhimtarie gjithmonë duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë, sidomos sigurimit të materialit fillestar, i cili para së gjithash duhet të jetë i shëndoshë për nga gjendja shëndetësore dhe pastërtia varietore, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet prodhimtaria e qëndrueshme e pemishtes.

Vitet e fundit është rritur në mënyrë të dukshme interesimi i fermerëve për prodhimin e materialit fidanor të pemëve të prodhuara mbi nënshartesa vegjetative. Sektori i pemëtarisë e veçanërisht prodhimtaria e fidanëve konsiderohet sektor me rendësi ekonomike. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet përmirësimi i teknikave të prodhimit të fidanëve të pemëve dhe aplikimit të teknologjive të reja që bëjnë të mundur rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe shtimin e numrit të fidanëve të pemëve drufrutore.

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte në prodhimin e fidanëve të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative do t'i kontribuojë realizimit të këtij objekti.

Ngritja e cilësisë si dhe rritja e numrit të fidanëve të pemëve drufrutore, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsytet e përkrahjes së këtij sektori, duke marrë për bazë numrin e fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i ka vendi.

4. QËLLIMI PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët prodhojnë fidanë të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e sipërfaqeve të mbjella me pemë drufrutore;
- Rritja e sipërfaqeve të mbjella me vreshta;
- Rritja e të hyrave në fermë;
- Zvogëlimi i importit;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Përmirësimi i cilësisë së materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative;
- Aplikimi i teknologjive bashkëkohore - mbjellja intensive;
- Përmirësimi i strukturës varietore;
- Zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të prodhimit të fidanëve të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët që prodhojnë material fidanor të pemëve dhe hardhisë:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët prodhojnë material fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të posedojnë së paku 0.50 hektarë tokë bujqësore (në pronësi të tyre ose të marrë me qira);
- Sipërfaqja e tokës bujqësore e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për 2 (dy) vite;
- Fermeri, gjatë vitit kalendarik 2016, duhet të prodhojë së paku 5000 fidanë të pemëve drufrutore ose hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative.

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirrollogarinë bankare të subjektit;
- Kopjen e certifikatës së biznesit dhe informatën mbi biznesin;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshminë - vërtetimin për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Kopjen e Licencës së MBPZHR-së për prodhimin e materialit fidanor të pemëve;
- Kopjen e Licencës së MBPZHR-së për prodhimin e materialit fidanor të hardhisë së rrushit;
- Kopjen e deklaramentit të sasisë së prodhuar të fidanëve për vitin kalendarik 2016 të vërtetuar nga Inspektori Fitosanitar-AUV (ky dokument merret në DPBT-MBPZHR dhe sillet/dorëzohet pasi të kryhet deklarimi i sasisë së prodhuar të fidanëve);
- Kopjen e certifikatës fitosanitare mbi gjendjen shëndetësore të fidanëve të prodhuar në vitin kalendarik 2016 (ky dokument sillet/dorëzohet pas bërjes së analizave të fidanëve për gjendjen shëndetësore);
- Dëshminë - procesverbalin nga Inspektori Fitosanitar-AUV për posedimin e pemishtes amë të nënshartësive vegjetative;
- Dëshminë-procesverbalin nga Inspektori Fitosanitar-AUV për posedimin e vreshtit amë të nënshartësive vegjetative;
- Për nënshartesat vegjetative të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit të sjella nga importi, fermeri duhet t'i posedojë këtë dokumentacion: certifikatën fitosanitare për gjendjen shëndetësore të nënshartësive vegjetative të lëshuar nga vendi-shteti prej të cilit janë importuar nënshartesat vegjetative dhe dokumentin unik doganor (DUD) që dëshmon se nënshartesat janë futur në Kosovë në mënyrë të rregullt përmes doganës;
- Dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore;
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira e cila duhet të jetë e lidhur së paku për 2 (dy) vite dhe e nënshkruar në mes të dy palëve - qiradhënësit

dhe qiramarrësit.

- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për fidanë;
- Subvencionimi do të bëhet vetëm për fidanët njëvjeçar;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët gjatë vitit 2016 prodhojnë së paku 5000 fidanë të pemëve drufrutore ose hardhisë së rrushit mbi nënshartesa vegjetative;
- Fermerët që prodhojnë prej 5000 deri 40000 fidanë të pemëve drufrutore mbi nënshartesa vegjetative do të subvencionohen në vlerë prej 0.20 €/fidan;
- Fermerët që prodhojnë mbi 40000 fidanë të pemëve drufrutore mbi nënshartesa vegjetative do të subvencionohen në vlerë prej 0.15 €/fidan;
- Fermerët që prodhojnë së paku 5000 e më shumë fidanë të hardhisë së rrushit do të subvencionohen në vlerë prej 0.10 €/fidan;

9. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 40 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi.

10. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve dhe kompletimit të dokumentacionit bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të fidanëve të prodhuar dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve/subjekteve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

11. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte (subvencionim) të fidanëve të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit të prodhuara mbi nënshartesa vegjetative është 100,000.00 €.

12. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

PAGESAT DIREKTE PËR PRODHIMTARIN ORGANIKE

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 01/17 Janar 2013);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);

- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. PËRSHKRIMI I SEKTORIT - RËNDËSIA E BUJQËSISË ORGANIKE:

Prodhimtaria Organike në Kosovë është ende në fazë të hershme të zhvillimit si në prodhim ashtu edhe në konsum, mirëpo sa i përket mundësisë së zhvillimit të këtij sektori konsiderohet se Kosova ka kushte natyrore mjaftë të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë organike. Në Kosovë sektori i bimeve medicinale dhe aromatike është mjaftë i konsoliduar dhe për q' do vite ka rritje të siperfaqeve me këto kultura.

Në vitin 2014 ishin rreth 160 ha të kultivuara me bimë medicinale dhe aromatike.

Në Kosovë në mungesë të trupës certifikuese vendore certifikimi i prodhimeve organike/bimëve medicinale dhe aromatike si dhe zonat ku behet grumbullimi i frutave të malit bëhet nga trupa certifikuese ndërkombëtare, nga vendet e tjera, që janë të akredituara. Kostoja e certifikimit është mjaftë e lartë edhe ndikon në rritjen e kostos së prodhimit. Prandaj pa mbështetje financiare është mjaftë e vështirë që të përballohen të gjitha kostot e prodhimit nga vetë fermerët që merren me prodhimtari organike.

3. ARSYESHMËRIA E ZBATIMIT TË MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ka për qëllim promovimin dhe përkrahjen e zhvillimit të bujqësisë organike në Kosovë.

Kosova ka një potencial të lartë për zhvillimin e bujqësisë organike duke u bazuar në mënyrën tradicionale të kultivimit sidomos në zonat e thella rurale si dhe kërkesën e madhe të këtyre prodhimeve në tregjet e BE - së.

Sigurimi dhe siguria e ushqimit, ruajtja e ambientit, ruajtja e shëndetit të tokës, ndalimi i migrimit nga zonat rurale, ulja e kostos së prodhimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë arsytet e përkrahjes së këtij sektori.

4. QËLLIMI I PROGRAMIT:

Mbështetja direkte e fermerëve të cilët merren me prodhimtari organike.

4.1. Objektivat e programit:

- Rritja e të hyrave në fermë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e sipërfaqeve me prodhimtari organike.
- Përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor.

4.2. Objektivat specifike:

- Rritja e sipërfaqeve me prodhimtari organike;
- Rritja e rendimentit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;
- Intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

M.K

5. PËRFITUESIT/GRUPI I SYNUAR:

5.1. Fermerët të cilët merren me prodhimtari organike.

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët të cilët merren me prodhimtari organike.

5.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

6. KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT/APLIKUESIT:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 0.10 ha me kultura bujqësore me qëllim të prodhimit organik.
- Parcela e mbjellë me kultura bujqësore me qëllim të prodhimit organik duhet të jetë së paku 0.10 ha e pandarë;
- Sipërfaqja e marr me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për tre (3) vite;
- Sipërfaqja e marrë me qira duhet të jetë së paku 0.10 ha e pandarë;
- Në momentin e aplikimit fermeri duhet të deklaroj se cila kulturë bujqësore është e mbjellurë në ngastrën për të cilën aplikon.

7. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridikë;
- Dëshminë nga kadastra-fletën poseduese dhe kopjen e planit për sipërfaqen e tokës bujqësore për të cilën aplikon.
- Kontratën për sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira e cila duhet të jetë e lidhur dhe e nënshkruar në mes të dy palëve-qiradhënësit dhe qiramarrësit;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë;
- Dëshmi certifikimi për ngastrën-parcelën dhe kulturën bujqësore të mbjellurë në atë ngastër-parcelë. Dëshmia lëshohet nga trupa e kontrollit (trupa certifikuese) e akredituar në nivel të BE-së dhe duhet të silltet pasi të realizohet certifikimi dhe fermeri të pajiset me këtë dokument.

8. MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqe/hektar, në vlerë prej 200 €/ha;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët kanë të mbjellë së paku 0.10 ha me kultura bujqësore dhe për të cilën posedojnë dëshminë se është certifikuar si prodhim organik.

9. REALIZIMI I PAGESAVE:

Pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve dhe kompletimit të dokumentacionit bëhet pagesa e fermerëve përfitues, sipas numrit të hektarëve të mbjellë dhe të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve/aplikuesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

Sqarim:

Prodhimtaria organike ka specifikat e veçanta të prodhimit në krahasim me prodhimet e tjera, prandaj gjatë implementimit të Programit të Pagesave Direkte për sektorin e prodhimit organike duhet pasur kujdes, pasi që fermerët aplikojnë për sipërfaqe të caktuar por që certifikimi i sipërfaqes realizohet nga trupa e kontrollit (trupa certifikuese) dhe si rezultat mund të mos certifikohet e tërë sipërfaqja për të cilën ka aplikuar fermeri. Prandaj në këtë rast duhet realizuar pagesa vetëm për sipërfaqen që është certifikuar si organike por jo edhe të merren masat ndëshkimore me futjen e fermerit në listën e zezë pasi që kjo nuk nënkupton tentim për mashtrim por mos përmbushje të kritereve për certifikim të prodhimit organik.

10. MËNYRA E APLIKIMIT:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve, si dhe digjitalizimi i parcelave do të zgjatë 40 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi.

11. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte (subvencionimi) për prodhimtari organike është 100,000.00 €.

12. IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT:

Implementimi bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

PAGESAT DIREKTE PËR: LOPË DHE BUALLICA QUMËSHTORE, DELE, DHI, DOSA PËR RIPRODHIM, BLETË, QUMËSH SIPAS KATEGORIVE TË CILËSISË, PULA VOJSE, THËLLËZA DHE THERJET E RAPORTUARA TË GJEDHIT

1. LEGJISLACIONI REFERUES:

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27. 07. 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 49/25. 03. 2009);
- Ligji Nr. 03/L-029 për Inspeksionin Bujqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 45/12. 01. 2009);
- Ligji Nr 04/L-085 për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 2004/21 për Veterinarinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/01. 11. 2007);
- Ligji Nr. 04/L-191 për Blegtorinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 25/08 Korrik 2013);
- Ligji Nr. 02/L-10 për Përkujdesjen Ndaj Kafshëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 5/01. 10. 2006);
- Ligji Nr. 02/L-111 për Bletari (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 35/15. 08. 2008);

- Ligji Nr.02/L-85 Për Peshkatari dhe Akuakulturë;
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr. 9/2008 Për Licencimin e aktiviteteve të Akuakulturës;
- Udhëzimi Administrativ MBPZHR-së Nr.04/2016 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2016.

2. RËNDËSIA E BLEGTORISË - PËRSHKRIMI I SEKTORIT

Blegtoria është veprimtari fitimprurëse me rëndësi ekonomike pasi që ekzistojnë resurset natyrore për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale. Blegtoria është prodhuese e ushqimeve me vlerë të lartë ushqyese (qumësht, mish dhe prodhime bletare) dhe promotorë i zhvillimit të aktiviteteve tjera bujqësore (prodhimtarisë bimore dhe industrisë përpunuese).

Pavarësisht rezultateve inkurajuese dhe predispozitive gjeografike, resurseve të cilat i disponon vendi për zhvillimin e sektorit të blegtorisë, në këtë sektor janë evidente vështirësi të cilat mund të reflektohen negativisht në zhvillimin e përgjithshëm të aktiviteteve blegtorale. Pamundësia e fermerëve për investime me qëllim të rritjes së kapaciteteve, sistemi kreditues i pavolitshëm, importet nga vendet kryesisht të rajonit të cilët aplikojë masa stimuluese për eksport (subvencionimi i eksportit) etj., paraqesin problem serioz për prodhimtarinë vendore dhe perspektivën e sektorit.

3. ARSYESHMËRIA E MASËS:

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh intensifikimin e aktiviteteve blegtorale me qëllim të shfrytëzimit të resurseve natyrore të cilat i disponon vendi dhe krijimin e një bujqësie/blegtorie të konsoliduar fitimprurëse me prodhimtari konkurrenente në rajon dhe garanci për shëndetin e konsumatorit.

Ngritja e prodhimtarisë kërkon edhe ngritjen kapaciteteve përpunuese dhe intensifikimin e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve përpunuese të tanishme. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ngritjes së nivelit të sigurisë së konsumatorit, gjë që pretendohet të arrihet përmes:

- Ngritjes së madhësisë së fermave dhe modernizimit të teknologjive;
- Aplikimit të standardeve të sigurisë së ushqimit;
- Minimizimit të efekteve anësore në ndotjen e ambientit.

4. QËLLIMI PROGRAMIT:

Mbështetja direkte për fermerët mbarështues të lopëve dhe buallicave qumështore, deleve, dhive, bletëve, dosave për riprodhim, pulave vojse, thëllëzave, qumështit të freskët Klasa ekstra, Klasa I-rë dhe Klasa II-të, therjeve të raportuara të gjedhit dhe akuakultures.

5. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT:

Objektivat e përgjithshme:

- Përmirësimi i të hyrave në fermë;
- Rritja e madhësisë së fermës, dhe
- Siguria e ushqimit.

5.2 Objektivat specifike:

- Intensifikimi dhe ekonomizimi i aktiviteteve blegtorale dhe bletare;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve;
- Mirëmbajtja e bazës së të dhënave në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve AUV;
- Zvogëlimi i ndikimit negativ në mjedis;
- Ndalimi i qarkullimit ilegal të gjedhit;
- Zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të prodhimit;
- Nxitja e aktiviteteve të fermerëve dhe aftësisë konkurruese.

6. PAGESAT DIREKTE PËR LOPË DHE BUALLICA QUMËSHTORE

Gjedhët (duke përfshirë edhe buallicat) janë popullimi më i madh i kafshëve blegtorale dhe si i tillë janë bartës të prodhimit të qumështit, prandaj prodhimtaria e gjedhit është veprimtari e pjesës dërmuese të fermave komerciale dhe ekonomive familjare.

Vlerësohet se fondi i gjedhit në Kosovë është mbi 261000 krerë, prej të cilave për prodhimtarinë e qumështit janë rreth 134000 krerë.

6.1. Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarësojnë lopë dhe buallica qumështore në të gjitha fazat e prodhimit të qumështit dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

6.2. Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarësojnë së paku 5 krerë lopë qumështore dhe buallica qumështore ose së paku 5 krerë lopë qumështore dhe buallica qumështore së bashku;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara (pllaka që u vendosen në vesh me numra të veçantë) me matrikull të Republikës së Kosovës ose shteteve të BE-së;
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar.

6.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit;
- Regjistrin e lëshuar nga Praktikat Veterinare të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

6.5. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për krerë, në vlerë prej 70 €/krer;

7. PAGESAT DIREKTE PËR DELET DHE DHITË

Delet dhe dhitë janë popullimi i kafshëve blegtorale që dominojnë në zonat e thella rurale dhe si të tilla janë bartëse të prodhimtarisë blegtorale. Sipas të dhënave statistikore, fondi i deleve dhe dhive në Kosovë është rreth 212000 krerë, prej të cilave në prodhimtarinë e qumështit janë rreth 206000 krerë.

7.1. Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë dele dhe dhi qumështore në të gjitha fazat e prodhimtarisë së qumështit dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

7.2. Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku 30 krerë dele dhe së paku 20 krerë dhi qumështore në prodhimtarinë aktive të qumështit;
- Kafshët duhet të jenë të matrikulluara (pllaka që u vendosen në vesh me numra të veçantë) me matrikull të Republikës së Kosovës ose shteteve të BE-së;
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar.

7.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit;
- Regjistrin e lëshuar nga Praktikat veterinare të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.
- Dëshmi mbi kryerjen e vaksinimit të tufës/kopesë kundër sëmundjes së Brucelozës, dokumenti sillet pasi të përfundon vaksinimi i rregullt vjetor.

7.4 Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për krerë, në vlerë prej 15 €/krerë;

8. PAGESAT DIREKTE PËR BLETARI

Bletaria është një ndër lëmit boshte të bujqësisë në Kosovë. Vendi ynë ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e bletarisë duke u bazuar në disponueshmerin e rrallë të klimës, reliefit apo edhe numrit të madh të bimëve mjaltëdhënëse, të cilat garantojnë një prodhimtari të mirë të produkteve të bletës. Sipas të dhënave statistikore, fondi i koshereve në Kosovë është rreth 11600 koshere.

8.1. Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë bletë dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

M.K.

8.2. Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë minimum 30 shoqëri bletësh (koshere);
- Fermerët që kanë 30 deri 50 shoqëri bletësh (koshere) mund ti kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në dy (2) bletishte, fermerët që kanë mbi 50 deri 200 shoqëri bletësh (koshere) mund ti kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në pesë (5) bletishte, fermerët që kanë mbi 200 shoqëri bletësh (koshere) mund ti kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në 7 bletishte;
- Kosheret duhet të jenë të shënuara me numër identifikues të pronës sipas një rregullimi të brendshëm nga MBPZHR-ja dhe fermerët do të njoftohen në momentin e aplikimit.

8.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirrollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës për prodhimin organike të mjaltit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga trupa certifikues (vetëm për fermerët e certifikuar për prodhimin e mjaltit organik);
- Fermerët e certifikuar për prodhimin e mjaltit organik, kopjen e certifikatës duhet t'ia bashkëngjisin dokumentacionit jo më larg se 10 ditë nga data e certifikimit;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.
- Dëshmi individuale të vërtetuara nga Drejtoria Komunale për Bujqësi-Komuna për numrin e shoqërive të bletëve dhe vendndodhjen e shoqërive të bletëve;
- Certifikata veterinare-shëndetësore e lëshuar nga Praktikat Veterinare të licencuara nga AUV.

8.4. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për shoqëri bletësh (koshere), në vlerë prej 15 € /shoqëri bletësh (koshere);
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë së paku 30 shoqëri bletësh (koshere), ndërsa fermerët e certifikuar për prodhimtari organike të mjaltit subvencionohen në vlerë prej 20 € /shoqëri bletësh (koshere) dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

9. PAGESAT DIREKTE PËR QUMËSHT SIPAS KATEGORIVE TË CILËSISË

Me këtë program rregullohen kushtet dhe mënyra e subvencionimit të qumështit sipas kategorive të cilësisë për vitin 2016 bazuar në legjislacionin në fuqi. Të drejtën e shfrytëzimit të subvencionit e kanë të gjithë personat juridikë dhe fizikë, bartës të ekonomive familjare, komerciale dhe jokomerciale.

9.1. Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues do të jenë fermerët prodhues të qumështit Klasa ekstra, Klasa I-rë dhe Klasa II-të sipas standardeve të kategorizimit bazuar në legjislacionin në fuqi.

M.K

9.2. Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të regjistruar në regjistrin e bizneseve të Kosovës (personat juridikë);
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, numri i kafshëve në ferme dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar.
- Të kenë kontratën për shitjen e qumështit me ndonjërën nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërën nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërën qumështore të licencuar.
- Të ofrojë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën e grumbullimit të qumështit e cila është e regjistruara si biznes dhe ka kontratë me ndonjërën qumështore të licencuar, i pranueshëm për pagesë është qumështi i kategorive: Ekstra, Klasi i Parë dhe i Klasi i Dytë;
- Të dorëzojë më së paku 1500 litra qumësht për 3 (tre) muaj (sipas tremujorëve të vitit kalendarik).
- Të ofrojë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërën nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose në ndonjërën nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërën qumështore të licencuar;
- Të ofrojë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

9.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit (për persona juridikë), dokumentin i cili vërteton se kush e ka autoritetin që të nënshkruajë për kompaninë;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e listës së verifikimit të gjedhëve, të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I&R) në kuadër të AUV;
- Kopjen e kontratës për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërën qumështore të licencuar.
- Dëshminë për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose në pikën e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznes dhe e cila ka kontratë me ndonjërën qumështore të licencuar;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit të pikës grumbulluese dhe kopjen e kontratës së pikës grumbulluese me ndonjërën nga qumështoret e licencuara;
- Dëshminë e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të dorëzuar;
- Dëshminë nga AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar;
- Dëshminë për pjesëmarrjen në projektin "Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit";
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

9.4. Mënyra subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar, sipas kategorive:

1. Ekstra klasë	0.06 €
2. Klasa e Parë	0.04 €
3. Klasa e Dytë	0.02 €

9.5. Garantimi i Çmimit:

Kontrata për furnizim me qumësht, në mes të qumështores dhe fermerit, paraqet kushtet e pagesës së qumështit. Çmimi vjetor bazë sipas sezonit, duhet të jetë i aprovuar sipas marrëveshjes së nënshkruar nga shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit dhe për të njëjtën duhet të informohet MBPZHR-ja.

9.6. Realizimi i pagesave për qumësht sipas kategorive të cilësisë:

Realizimi i pagesave direkte për qumështin sipas kategorive të cilësisë, bëhet pas hartimit të listave përfundimtare të fermerëve/përfituesve sipas kategorisë së cilësisë së qumështit. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve/përfituesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

9.7. Thirrja për aplikim për pagesa direkte të qumështit sipas kategorive të cilësisë:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve/aplikuesve për pagesa direkte të qumështit sipas kategorive të cilësisë do të publikohet/shpallet çdo tremujor dhe do të zgjasë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi.

10. PAGESAT DIREKTE PËR PULA VOJSE

Sektori i shpezëtarisë, posaçërisht prodhimi i vezëve për konsum është shumë i rëndësishëm dhe mjaft i ndjeshëm në Kosovë, për shkak të strukturës së fermave. Shpezëtaria ndër vite ka pasur rritje të konsideruar falë ekzistimit të kapaciteteve si teknike dhe njerëzore. Sipas të dhënave, ky sektor ka arritur shkallë të lartë të konkurrueshmërisë, vetëmjaftueshmërisë dhe të konsolidimit. Aktualisht fondi i pulave në prodhimtarinë aktive vlerësohet të jetë rreth 1,700,000 pula vojse.

10.1. Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues do të jenë fermerët mbarështues të pulave vojse në të gjitha fazat e prodhimtarisë aktive, të cilët janë të regjistruar si biznes dhe të cilët i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

10.2. Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku 2000 pula vojse në të gjitha fazat e prodhimtarisë aktive të vezëve;
- Mbështeten pulat vojse në të gjithë ciklin e prodhimit të vezëve;
- Subjekti duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e biznesit;
- Subjekti duhet të jete i regjistruar pran AUV.

M.K

10.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopjen e certifikatës së biznesit;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshmi - vërtetim për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të subjektit;
- Kopjen e dëshmisë për numrin dhe origjinën e zogjeve një ditore për pula vojse ose të pulave vojse, fatura e furnizimit nga importuesi dhe prodhuesi;
- Për pulat vojse dhe zogjtë një ditore për pulat vojse, fatura e furnizimit vlen nga data 01 qershor 2015 deri me 31 tetor 2016;
- Certifikata veterinare-shëndetësore e lëshuar nga Praktikat Veterinare të licencuara nga AUV;
- Vërtetimin që është i regjistruar në AUV;
- Dëshmi nga veterinari për aplikimin e programit të vaksinimit;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

Sqarim: Në rast se subjektet/aplikuesit e realizojnë ndërrimin e turnusit të pulave vojse mbas thirrjes për aplikim, atëherë duhet që të sjellin në AZHB faturat e furnizimi para se të realizohet kontrolla në teren nga ana e Inspektorëve të AZHB-së.

10.4. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për pulë vojse në të gjitha fazat e prodhimtarisë aktive të vezëve sipas madhësisë së tufës;
- Subvencionimi bëhet vetëm për një turnus të prodhimtarisë brenda vitit kalendarik.

Madhësia e tufës - shuma e pagesës direkte për pulë vojse:

- Nga 2 000 deri 10 000 pula vojse	0.50 €/pulë vojse
- Mbi 10 000 pula vojse	0.40 €/pulë vojse

11. PAGESAT DIREKTE PËR THËLLËZA

Thëllënzat hynë në kategorinë e shpezëve, ku produktet e tyre si mishi dhe vezët janë ushqime me vlera të larta ushqyese dhe konsumohen nga të gjitha kategoritë dhe grupmoshat. Sipas të dhënave të grumbulluara nga terreni aktualisht fondi i thëllënzave sillet rreth 15000 copë, por me tendencë të rritjes nga viti në vit.

11.1. Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues do të jenë fermerët mbarështues të thëllënzave në të gjitha fazat e prodhimtarisë aktive, të cilët janë të regjistruar në regjistrin e fermës dhe të cilët i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

11.2. Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

M.V.

- Të mbarështojnë së paku 100 thëllëzave vojse;
- Mbështeten thëllëzat në gjithë ciklin e prodhimit;

11.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës; ;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të fermerit;
- Certifikata veterinare-shëndetësore e lëshuar nga Praktikat Veterinare të licencuara nga AUV;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë;

11.4. Mënyra e subvencionimit:

- Pagesa direkte do të bëhet për njësi-copë, në vlerë prej 1 €/thëllëzë, në të gjitha fazat e prodhimitarisë.

12. PAGESAT DIREKTE PËR DOSAT PËR RIPRODHIM

Derri si kategori e kafshëve blegtorale shfrytëzohet për prodhimtarinë e mishit dhe atë kryesisht në ekonomitë familjare. Sipas të dhënave statistikore, rezultojnë se fondi i derrave është rreth 34000 krerë, ndërsa i krerëve të dosave për riprodhim është rreth 19 000 krerë. Gjithnjë sipas të dhënave nga analizat zooteknike rezultojnë se shkalla e shtimit të derrave në vend është 2 pjellje në vit me mesatare 8 gica/pjellje. Prodhimtaria e mishit të derrit është orientuar në plotësimin e nevojave të ekonomive familjare me tendencë ngritjen në nivel të fermave komerciale.

12.1. Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues sipas këtij programi do të jenë fermerët që mbarështojnë dosat për riprodhim në të gjitha fazat e riprodhimit, të cilët i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

12.2. Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë minimum 2 e më shumë dosat për riprodhim aktiv në të gjitha fazat e riprodhimit;
- Kafshët duhet të jenë të matrikulluara me matrikull (pllaka që u vihen në vesh me numër të regjistrimit) të Republikës së Kosovës ose shteteve të BE-së;
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar.

12.3. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të fermerit;
- Regjistrin e lëshuar nga Praktikat veterinare të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit & Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë;

- Dëshmi për kryerjen e vaksinimit kundër murtajës klasike të derrave, dokumenti sillet pasi të përfundon vaksinimi i rregullt vjetor.

12.4. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për krerë, në vlerë prej 20 €/krer;
- Përfitues do të jenë fermerët të cilët mbarështojnë minimum 2 krerë dosa për riprodhim dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

13. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

14. THIRRJA PËR APLIKIM PËR PAGESA DIREKTE PËR KRERË TË BAGËTIVE, KOSHERE TË BLETËVE, PULAVE VOJSE DHE THËLLËZAVE:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të fermerëve për pagesa direkte për lopë qumështore, buallica qumështore, dele, dhi, dosat për riprodhim, bletë, pulave vojse dhe thëllëza, do të zgjatë 40 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi.

15. REALIZIMI I PAGESAVE PËR KRERË TË BAGËTIVE, KOSHERE TË BLETËVE PULA VOJSE DHE THËLLËZA:

Realizimi i pagesave direkte për lopë qumështore, buallica qumështore, dele, dhi, dosa për riprodhim, bletë, pula vojse dhe thëllëza do të bëhet pas kompletimit të dokumentacionit dhe hartimit të listave përfundimtare të përfituesve, sipas numrit të krerëve, familjeve të bletëve, numrit të pulave vojse dhe numrit të thëllëzave të verifikuar nga inspektorët e AZHB-së. Pagesat bëhen në xhirollogaritë bankare të fermerëve/përfituesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

16. PAGESAT DIREKTE PËR THERJET E RAPORTUARA TË GJEDHIT

Fondi i gjedheve është rreth 261000krerë. Sipas të dhënave të AUV-së gjatë vitit theren rreth 150000 krerë, por theren numër i vogël i krerëve në thertoret e licencuara. Therjet ilegale ndikojnë negativisht në implementimin e legjislacionit, ruajtjen e shëndetit të kafshëve, shëndetit publik dhe në ruajtjen e mjedisit (trajtimi joadekuat i nënprodukteve nga kafshët e therura).

16.1. Përfituesit/grupi i synuar:

Përfitues do të jenë fermerët që mbarështojnë gjedhe të identifikuar me matrikull të Republikës së Kosovës dhe të cilat theren në thertoret e licencuara nga AUV; dhe

- Thertoret e licencuara nga AUV, për kategoritë të sigurisë A, B dhe C (në vitin 2017 do të eliminohen thertoret e kategorisë C).

16.2. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

16.3. Kriteret që duhet t'i plotësojnë aplikuesit/thertoret:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

M.K.

- Të jenë të licencuara nga AUV në kategorinë A, B dhe C;
- Të raportojnë therjet në bazën e të dhënave në Sektorin e Identifikimit dhe Regjistrimit në AUV, sipas dinamikës së paraparë të thertores;
- Gjedhet duhet të jenë të matrikulluara me matrikull (pllaka që u vihen në vesh me numër të regjistrimit) të Republikës së Kosovës;

16.4. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit/subjektit;
- Kopjen e licencës së lëshuar nga AUV-ja;
- Kopjen e certifikatës së biznesit dhe informatat e biznesit;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshminë/vërtetimin për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Regjistrin e kafshëve të therura, të lëshuar nga baza e të dhënave të sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit-AUV, të dëshmuar me pasaportën e kafshës së theruar;
- Dëshminë/fletëpagesën, me të cilën vërtetohet se është realizuar pagesa nga thertorja te fermeri, në vlerë prej 20 €/krerë gjedhe të therur.

16.5. Mënyra e subvencionimit:

- Pagesa do të bëhet për krerë gjedhe të therur, në vlerë prej 30 €/krerë.
- Pagesës në vlerë prej 30 euro/krerë u bëhet thertoreve përfituese;
- Thertoret obligohen që vlerën e mjeteve prej 20 euro t'ia paguajnë fermerit në momentin e therjes së gjedhit. Ndërsa vlera e mjeteve prej 10 euro i mbetet thertores për shërbimin të therjes.

16.6. Thirrja për aplikim për pagesa direkte për therjet e raportuara të gjedhit:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të thertoreve për pagesa direkte për therjet e raportuara të gjedhit do të publikohet/shpallet çdo tremujor dhe do të zgjatë 30 ditë nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi.

16.7. Realizimi i pagesave për therjet e raportuara të gjedhit:

Realizimi i pagesave direkte për therjet e raportuara të gjedhit, do të bëhet pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve sipas numrit për krerë gjedhe të therur, të verifikuar nga AZHB. Pagesat bëhen në xhirollogarinë bankare të përfituesve-thertoreve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

16.8. Implementimi i programit:

Implementimi i programit bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

17. PAGESAT DIREKTE PER SEKTORIN E AKUAKULTURËS

Sektori i akuakulturës në Kosovë krahasuar me vendet e regjionit dhe të Evropës është i vogël, prodhohet sasi minimale e mishit të peshkut rreth 700 000 kg/vit, prodhimtaria kryesisht konsumohet në hoteleri dhe shumë pak gjendet në treg. Në Kosovë ka dy forma të sigurimit të peshkut për konsum:

- a) Nga mbarështimi i peshqve në ferma të peshkut, respektivisht hurdha, dhe

M.K

b) Nga Aktiviteti i peshkimit sportiv-rekreativ

Nga sasia e përgjithshme e prodhimit që është rreth 700 000 kg/vit, vetëm 60 000 kg/ vit vijnë nga aktiviteti i peshkimit sportiv-rekreativ, ndërsa pjesa tjetër është prodhim që vije nga mbarështimi i peshkut nëpër hurdha.

Sipas të dhënave ekzistojnë 28 hurdha të peshkut, ku vetëm në një të një prej tyre mbarështohet lloji i peshkut Krap, ndërsa në 27 hurdhat tjera mbarështohet lloji i peshkut Trofta.

Nga 28 hurdhat që janë në prodhimtari aktive, 21 prej tyre prodhojnë për nevoja të hotelerisë, 7 janë me veprimtari të përzier hoteleri plasman në treg.

Struktura e sektorit kryesisht dominohet nga hurdhat e vogla që mbarështojnë rreth 10000 kg peshk/vit. Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese është rreth 50 %.

17.1. Objektivat e përgjithshme:

- Përmirësimi i të hyrave në fermë;
- Rritja e madhësisë së fermës;
- Siguria e ushqimit.

17.2. Objektivat specifike:

- Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve;
- Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese dhe rritja e numrit të fermave të reja
- Rritja e prodhimtarisë dhe inkurajimi i procesit të përpunimit të peshkut.
- Zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të prodhimit;
- Rritja e furnizimit të tregut me prodhime të akuakulturës / peshk të freskët.

17.3. Përfituesit/grupi i synuar:

- Përfitues do të jenë fermat të cilët mbarështojnë (prodhojnë) peshkun, dhe që janë të regjistruar si biznes dhe të cilët i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

17.4. Shtrirja gjeografike:

- Tërë territori i Republikës së Kosovës.

17.5. Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Të shesin së paku 2500 kg peshk brenda gjashtë (6) muajve, në Republikën e Kosovës. Llojet e pranueshme të peshkut janë Trofta dhe Krap;
- Të jetë i licencuar nga MBPZHR për zhvillimin e aktiviteteve në akuakulturë;
- Të ketë lejen e shfrytëzimit të ujërave lëshuar nga MMPH;
- Të ketë pëlqimin mjedisorë për ndërtimin e hurdhës.

17.6. Dokumentacioni i nevojshëm;

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopjen e licencës së MBPZHR;
- Kopjen e certifikatës së biznesit;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshmi - vërtetim për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të subjektit;

M. K.

- Certifikatën veterinare-shëndetësore të lëshuar nga Praktikat Veterinare të licencuara nga AUV;
- Dëshminë për sasinë dhe vendin e origjinës së ushqimit për peshk;
- Dëshminë nga ATK për sasinë e shitur të peshkut;
- Dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë.

17.6. Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për kg të peshkut të shitur në vlerë prej 0.20 euro.
- Do të mbështeten (subvencionohen) të gjithë fermat-pronarët e hurdhave të peshkut që shesin së paku **2500 kg/peshk** brenda gjashtë muajve, në Republikën e Kosovës. Llojet e pranueshme të peshkut janë Trofta dhe Krapa.

17.7. Thirrja për aplikim për pagesa direkte sektorin e akuakulturës:

Procesi i regjistrimit dhe aplikimit të subjekteve/aplikuesve për pagesa direkte për sektorin e akuakulturës do të publikohet/shpallet çdo gjashtëmujor dhe do të zgjatë **30 ditë** nga data e publikimit. Aplikimi bëhet në Drejtoritë Komunale për Bujqësi.

17.8. Realizimi i pagesave për sektorin e akuakulturës:

Realizimi i pagesave direkte për sektorin e akuakulturës, do të bëhet pas hartimit të listave përfundimtare të përfituesve sipas sasisë së shitur të peshkut, të dëshmuar me dokument zyrtar të lëshuar nga ATK dhe të verifikuar nga AZHB. Pagesat bëhen në xhironlogaritë bankare të përfituesve, verifikimi i të cilave është bërë gjatë aplikimit.

17.9. Implementimi i programit:

Implementimi i programit bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

18. BUXHETI I PLANIFIKUAR:

Për pagesat direkte në sektorët e prodhimit të prodhimit të blegtorale është:

➤ Lopë dhe buallica qumështore:	3,600,000.00 €
➤ Dele:	1,700,000.00 €
➤ Dhi:	150,000.00 €
➤ Bletari:	1,500,000.00 €
➤ Qumështi sipas kategorive të cilësisë:	1,000,000.00 €
➤ Pulat vojse:	210,000.00 €
➤ Thëllëzat:	20,000.00 €
➤ Dosat për riprodhim:	20,000.00 €
➤ Therjet e raportuara të gjedhit:	150,000.00 €
➤ Akuakultura:	100,000.00 €